



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT
AGJENCIA KOMBËTARE E FINANCIMIT TË ARSIMIT TË LARTË
BORDI DREJTUES

Nr. 102/3 Prot.

Tiranë, më 26.05.2025

VENDIM

Nr. 06 Datë 26.05.2025

PËR

"MIRATIMIN E MARRËVESHJES DY PALËSHE, PËR GARANTIMIN E SKEMËS SË KREDITIMIT STUDENTOR, SIPAS VKM NR.440/2023, I NDRYSHUAR, QË AGJENCIA KOMBËTARE E FINANCIMIT TË ARSIMIT TË LARTË DO TË LIDH ME BANKËN E NIVELIT TË DYTË"

Bordi Drejtues i Agjencisë Kombëtare të Financimit të Arsimit të Lartë, në mbështetje të nenit 11, pika 1 gërma "c", të Ligjit nr.80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", të gërmës "c" të pikës 3 dhe gërmës "d" të pikës 6, të VKM nr.397, datë 03.05.2017 "Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Financimit të Arsimit të Lartë (AKFAL)", të pikës 11, të VKM nr.440, datë 19.07.2023 "Për përcaktimin e skemës së kreditimit studentor", i ndryshuar, si dhe në zbatim të Rregullores së Brendshme të Bordit Drejtues të AKFAL,

VENDOSI:

1. Miratimin e marrëveshjes dy palëshe, për garantimin e skemës së kreditimit studentor, sipas VKM nr.440/2023, i ndryshuar, që Agjencia Kombëtare e Financimit të Arsimit të Lartë do të lidh me Bankën Credins.
2. Pjesa e normës së interesit të kredive studentore, që do të financohet nga Agjencia Kombëtare e Financimit të Arsimit të Lartë, për kontratat e kredisë që banka do të kontrakttojë me studentët, në masën e përcaktuar në marrëveshje.
3. Ky vendim i përcillet Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.
4. Ngarkohet Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë Kombëtare të Financimit të Arsimit të Lartë, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

BORDI DREJTUES

KRYETARI

Erzen TOLA

ANËTARËT

Besmir BEJA

Artan HOXHA

Agron KASA

Spiro BRUMBULLI

Adresa: Rruga "Naim Frashëri", Nr.37, Tiranë, info.akfal@arsimi.gov.al